



01 Nr. 681/24 Dt. 04.11.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për formimin dhe emërimin e Komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve (ekspertëve të jashtëm) të cilët kanë aplikuar në thirrjen publike për anëtarë të komisionit për vlerësimin e projekt/propozimeve të OJQ-ve të pranuara sipas thirrjes publike të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Për anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Shykrane Berisha,..... kryesuese,
 - 1.2. Valmira Kasolli,..... anëtare,
 - 1.3. Imerdin Kukaj,..... anëtar.
 2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit nga pika 1 e këtij Vendimi janë: të shqyrtoj dhe vlerësoj të gjitha aplikacionet të cilët kanë arritur, konform thirrjes publike për anëtarë të komisionit për vlerësimin e projekt/propozimeve të OJQ-ve të pranuara sipas thirrjes publike dhe në bazë të akteve ligjore dhe nënligjor që e rregullojnë këtë lëmi, të bëjnë përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit përkatës.
 3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi.
 4. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.
- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

